



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 16 DHJETOR 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
16. DECEMBRA 2008. GODINE

DHJETOR – DECEMBAR
2008

Rendi i dities

1. Shqyrtimi i dytë i Grupit të tetë të projektligjeve nga Propozimi i Marti

Ahtisarit, sipas procedurës së veçantë: .

- 1.1 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të huajt;
- 1.2 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi;
- 1.3 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
- 1.4 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës;
- 1.5 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës;
- 1.6 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës.

Dnevni red:

1. Drugo razmatranje Osme grupe nacarta zakona iz Predloga Martti Ahtisarija, po posebnom postupku:

- 1.1 Drugo razmatranje Nacrta zakona o strancima;
- 1.2 Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama zakona o zdravstvu;
- 1.3 Drugo razmatranje Nacrta zakona o Ustavnom sudu Republike Kosova;
- 1.4 Drugo razmatranje Nacrta zakona o privremenom sastavu Sudskog veća Republike Kosova;
- 1.5 Drugo razmatranje Nacrta zakona o Službi spoljnih poslova Republike Kosova;
- 1.6 Drugo razmatranje Nacrta zakona o Konzularnoj službi diplomatskih i konzularnih misija Republike Kosova.

Agenda:

1. Second reading of the eight group of Draft laws from marti Ahtosaari1s proposal, according to special procedure:

- 1.1 Second reading of the Draft Law on Foreigners;
- 1.2 Second reading of the Draft Law on Amendment and Supplementation of the Law on Health;
- 1.3 Second reading of the Draft Law on Constitutional Court of Republic of Kosovo;
- 1.4 Second reading of the Draft Law on Provsional Content of Legal Council of Republic of Kosovo;
- 1.5 Second reading of the Draft Law on Foreign Service of Republic of Kosovo;
- 1.6 Second reading of the Draft Law on Consular Service of Diplomatic and Consular Missions in Republic of Kosovo.

Seanca plenare filloi punën në orën 14,00.

Seancën e drejtoi Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë, para se t'ia fillojmë punës, ju njoftoj se kryetari i Komisionit ad-hoc, ka kërkuar që të shtyhet fillimi i seancës për 20 minuta. Ju faleminderit!

(Pas pauze prej 20 minutash, seanca vazhdoi punën)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari Kryeministër, zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Fillojmë punën e seancës së sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 100 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Që në fillim ju njoftoj se, në pajtim me vendimin e Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin e ndërlidhur me të, sipas procedurës së veçantë, në seancën e sotme plenare do të procedohen në shqyrtimin e dytë projektligjet e miratuara, në parim, në seancën plenare të mbajtur më 15 dhjetor 2008.

Rendi i ditës, së bashku me rekomandimet e Komisionit ad-hoc, u është shpërndarë deputetëve.

Urdhëroni! Fjalën e ka Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,
Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë shpreh shqetësimin e radhës. Mbrëmë, për të satën herë, është cenuar sovraniteti dhe integriteti territorial i Kosovës nga ana e Republikës së Serbisë, me hapjen dhe vënien në shërbim të linjës hekurudhore Beograd – Kosovë Veriore.

Grupi Parlamentar i LDD-së kërkon nga Qeveria e Kosovës të japë informatë dhe të prononcohet para këtij Kuvendi se çka është duke ngjarë në këtë pjesë të territorit të Kosovës?

Cenimi i sovranitetit të territorit të Kosovës është veprim i radhës, atak mbi shtetin e Kosovës. Kemi obligim kushtetues, Qeveria e Kosovës e ka këtë mandat dhe obligim kushtetues ta garantojë sovranitetin e Kosovës.

Prandaj, Grupi Parlamentar i LDD-së edhe njëherë shpreh shqetësimin dhe kërkon nga Qeveria e Kosovës të prononcohet lidhur me këtë çështje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ju njoftoj se seanca, ju e dini, nuk është krejt e rregullt, është për çështje të caktuara dhe të drejtën për fjalë e kanë vetëm shefat e grupeve parlamentare. Deputeti Lulzim Zeneli, është shef i Grupit dhe, në konsultim me mua, e ka kërkuar fjalën dhe ia kam dhënë. Tani vazhdojmë punën.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i dytë i Grupit të tetë të projektligjeve nga Propozimi i Marti Ahtisarit, sipas procedurës së veçantë

Komisioni ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raporti i Komisionit u është shpërndarë deputetëve.

Ftoj zotin Ramadan Gashi që, në emër të Komisionit ad-hoc, ta arsyetojë raportin me rekomandime.

RAMADAN GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zoti Kryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni ad-hoc, në pajtim me vendimin e Kuvendit të Kosovës të 15 shkurtit 2008, në mbledhjet e mbajtura më 15 dhe 16 dhjetor 2008, shqyrtoi projektligjet e grupit të tetë nga propozimi i Marti Ahtisarit, të propozuara nga Qeveria, dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë

R A P O R T

1. Komisioni shqyrtoi Projektligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe vendosi t'i rekomandojë Kuvendit miratimin e Projektligjit, me ndryshimin, si vijon:

Amendamenti 1. Në tërë tekstin e Projektligjit, para fjalës “Kosovë” të shtohet fjala “Republikës”.

2. Komisioni shqyrtoi Projektligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe vendosi t'i rekomandojë Kuvendit miratimin e Projektligjit, pa ndryshime.

3. Komisioni shqyrtoi Projektligjin për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe vendosi t'i rekomandojë Kuvendit miratimin e Projektligjit, pa ndryshime.

4. Komisioni shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi dhe vendosi t'i rekomandojë Kuvendit miratimin e Projektligjit, me ndryshimet, si vijon:

Amendamenti 1.

Në tërë tekstin e Projektligjit, fjala “amendament” të zëvendësohet me fjalën “nen”.

Amendamenti 2.

Në nenin 30 shtohen 2 paragrafë të rinj: 30.3 dhe 30.4, të cilët kanë përmbajtjen, si vijon:

30.3. “Komuna e Mitrovicës së Veriut, komuna e Graçanicës dhe komuna e Shtërpçës do t'i kenë kompetencat vetjake për ofrimin e kujdesit shëndetësor dytësor, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë – marrjen në punë, pagesën e rrogave, aftësimin e personelit shëndetësor dhe administrativ, përkuqdesjen shëndetësore në përputhshmëri me udhëzimet dhe standardet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi”.

30.4.” Në përputhshmëri me Ligjin për vetëqeverisjen lokale, institucionet shëndetësore publike të nivelit dytësor kanë të drejtë të bashkëpunojnë me institucionet shëndetësore të komunave tjera, brenda sferës së kompetencave të tyre në fushën e kujdesit dytësor shëndetësor”.

Amendamenti 3.

Është riformulimi ku komuna e Mitrovicës së Veriut, e Graçanicës dhe ajo e Shtërpçës vendosin për përmbushjen e kushteve për fillimin e punës së institucioneve shëndetësore të kujdesit dytësor në komunat përkatëse.

Amendamenti 4.

Fshihet amendamenti 9 i tekstit që ka qenë.

5. Komisioni shqyrtoi Projektligjin për Shërbimin Konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës dhe vendosi t'i rekomandojë Kuvendit miratimin e Projektligjit, pa ndryshime.

6. Komisioni shqyrtoi Projektligjin për të huajt dhe vendosi t'i rekomandojë Kuvendit aprovimin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Të drejtën për fjalë nga 5 minuta e kanë shefat e grupeve parlamentare, por nuk kanë kërkuar fjalën.

Kalojmë në procedurën e votimit, sipas pikës së parë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligji për të huajt

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 87 vota “për”, 2 “kundër” dhe 5 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për të huajt.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi

Komisioni ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raporti i Komisionit u është shpërndarë deputetëve. Kryetari i Komisionit raportoi për këtë.

Kemi 4 amendamente.

Votojmë amendamentin numër 1.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 57 vota “për”, 10 “kundër” dhe 20 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 1.

Amendamenti 2.

Konstatoj se me 41 vota “për”, 22 “kundër” dhe 25 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 2.

Amendamenti 3.

Konstatoj se me 41 vota “për”, 19 “kundër” dhe 26 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 3.

Amendamenti i fundit 4.

Konstatoj se me 56 vota “për”, 12 “kundër” dhe 22 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 4.

Radha është për ta votuar ligjin në tërësi.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 43 vota “për”, 21 “kundër” dhe 22 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi.

Radha është për pikën e tretë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Ju e dëgjuat raportin e kryetarit të Komisionit.
Kemi një amendament.

Lus regjinë të përgatitet për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 78 vota “për”, 5 “kundër” dhe 6 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin numër 1.

Tash votojmë ligjin në tërësi. Votojmë tash:

Konstatoj se me 85 vota “për”, 4 “kundër” dhe 8 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
Ju faleminderit!

Në radhë është pika e katërt e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës

Komisioni ad-hoc e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime. E dëgjuat raportin e kryetarit të Komisionit. Nuk ka amendamente. Prandaj, tani e votojmë ligjin në tërësi.

Regjia, le të përgatitet për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 76 vota “për”, 4 “kundër” dhe 12 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Në radhë është pika e pestë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Ju dëgjuat fjalën e kryetarit të Komisionit dhe nuk ka amendamente. Prandaj, kalojmë menjëherë në votim.

Regjia, le të përgatitet për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 85 vota “për”, 3 “kundër” dhe 5 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Në radhë është pika e gjashtë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës

Edhe për këtë projektligj nuk ka amendamente. Kalojmë në votim.
Lus regjinë të përgatitet për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 86 vota “për”, 3 “kundër” dhe 4 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës.

Seancën e deklaroj të mbyllur.

Mirupafshim në seancën e radhës, që do të mbahet me 18 dhjetor 2008, në orën 10:00.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve